

## Çfarë kualifikimi iu nevojitet edukatorëve në institucione?

Rikonstruksioni për formimin gjuhësor të integruar në përditshmëri është një proces që ka filluar në shumë institucione. Për të plotësuar kërkesat e ndryshuara, personeli arsimor mund të kualifikohet më tej me kurse të certifikuara. Këto kurse kualifikimi do të subvencionohen nga Ministria e Familjes, Rinisë, Kulturës dhe Sportit të landit VV. Qëllimi është për të siguruar dhe për të përmirësuar cilësinë e kujdesit ditor për fëmijët në NRW përmes masave të duhura të arsimit dhe trajnimit. Sepse personeli arsimor në institucione dëshiron të shoqërojë dhe mbështesë fëmijën tuaj sa më mirë.

Ministerium für Kinder, Familie,  
Flüchtlinge und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen

Haroldstraße 4, 40213 Düsseldorf  
Telefon: 0211 837-02  
poststelle@mkffi.nrw.de  
www.chancen.nrw

 @ChancenNRW  
 @ChancenNRW  
 Chancen\_nrw  
 Chancen NRW



### Informacione shtesë

Broshura „Alltagsintegrierte Sprachbildung und Beobachtung im Elementarbereich“ [https://www.kita.nrw.de/file/1232/download?token=v3\\_YrAOk](https://www.kita.nrw.de/file/1232/download?token=v3_YrAOk)

KiTa.NRW – Formimi Gjuhësor  
<https://www.kita.nrw.de/fachkraefte-fachberatung/sprachliche-bildung>

### Të dhënat e kontaktit

Ministerium für Kinder, Familie,  
Flüchtlinge und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen

Haroldstraße 4, 40213 Düsseldorf  
E-Mail: [kita.nrw@mkffi.nrw](mailto:kita.nrw@mkffi.nrw)

## Formimi gjuhësor i integruar në përditshmëri dhe monitorimi për fëmijët në qendrat e kujdesit ditor

Informacion për prindërit

## Të dashur prindër,

Aftësitë e mira gjuhësore janë një parakusht për pjesëmarrje sociale, integrim dhe suksese të mëtejshme në shkollë dhe profesion. Mbështetja dhe inkurajimi i hershëm i zhvillimit gjuhësor të fëmijës tuaj është për këtë arsye një prioritet i punës arsimore në kopshtet dhe çerdhet tona. Gjetjet e fundit nga shkencat dhe praktika tregojnë se zhvillimi gjuhësor të fëmijët është ndikuar pozitivisht kryesisht nga bisedat e përditshme dhe stimuluese. Që nga 1 gusht 2014, edukimi gjuhësor gjithnjë e më shumë do të zhvillohet në jetën e përditshme të kopshteve.

Për të mundur formimin gjuhësor të integruar në përditshmëri në mënyrë individuale, zhvillimi gjuhësor i çdo fëmije do vëzhgohet që nga fillimi. Fëmija juaj ka potencial dhe aftësi për të njohur këtë, për ta mbështetur dhe për ta zhvilluar më tej.

Në këtë proces, hartimi i një partneriteti të suksesshëm arsimor mes prindërve dhe personelit arsimor është vendimtar. Mjedisi familjar vazhdon të jetë vendi i parë i përvetësimit të gjuhës. Shkëmbimi i ideve, njohurive, përvojës dhe burimeve ndihmon, që të zhvillohet një raport i përbashkët edukues dhe arsimor.

## Cilët fëmijë do mbështeten?

Në kuadrin e formimit gjuhësor të integruar në përditshmëri të gjithë fëmijët do të shoqërohen dhe mbështeten që nga fillimi në zhvillimin e aftësive të tyre gjuhësore. Këtu personeli arsimor në kopshte dhe çerdhe orientohet nga interesat dhe burimet e fëmijëve. Kjo siguron që çdo fëmijë të krijojë përvojë në bisedat e përditshme, këngë, situata lojërash etj. Përveç kësaj, do të vëzhgohen aftësitë gjuhësore të fëmijëve. Për këtë është i domosdoshëm një miratim nga prindërit për dokumentacionin arsimor (në përputhje me § 13b Rregullorja e Kopshteve). Gjetjet janë reflektuar edhe në hartimin e formimit gjuhësor të integruar në përditshmëri.

Nëse fëmija juaj nuk frekuenton çerdhen apo nëse ju nuk keni miratuar vëzhgimin e vazhdueshëm të aftësive gjuhësore të fëmijës tuaj nëpërmjet personelit arsimor, atëherë ndiqet procedura e mëposhtme: Zhvillimi i gjuhës te fëmija juaj do të përcaktohet dy vjet para se të regjistrohet për shkollë nga Zyra e Arsimit (sipas § 36 paragrafi 2 Ligji për Arsimin). Nëse konstatohet një nevojë për nxitje të zhvillimit gjuhësor, fëmija juaj do të marrë një nga masat përkatëse për zhvillimin gjuhësor. Këto mund të vendosen edhe në regjistrimin e fëmijës tuaj në një qendër të kujdesit ditor.



## Si ndodh vëzhgimi?

Vëzhgimi i zhvillimit gjuhësor si proces shoqëruar dhe zhvillues ndodh që prej vitit 2014/2015 në kopshte. Qëllimi është për të dhënë udhëzime dhe mbështetje të zhvillimit të gjuhës në mënyrë individuale dhe në këtë mënyrë të fillohet sa më shpejt të jetë e mundur.

Vëzhgimi ndodh në përditshmërinë e kopshteve, për të dokumentuar zhvillimin gjuhësor të fëmijës tuaj në mënyrë të vazhdueshme. Këtu në dispozicion të institucioneve janë vendosur metoda vëzhgimi të testuara shkencërisht. Megjithatë nevoja për terapi gjuhësore nuk mund të përcaktohet duke përdorur këtë metodë. Në një supozim përkatës, specialistët e edukimit rekomandojnë që fëmija juaj të shkojë te një pediatër për të filluar nxitjen nga një terapist i të folurit apo logoped.

Duke qenë se fitimi i njohurive për formimin gjuhësor individual është i lartë, specialistët e edukimit përshtatin vëzhgimin në përditshmërinë në kopshte. Në këtë rast në plan të parë ka një analizë përshkruese, e cila jep informacion mbi hapat e fundit të zhvillimit të fëmijës. Një analizë kompjuterike që na lejon krahasimin e zhvillimit gjuhësor të fëmijës tuaj me ato të fëmijëve të tjerë të së njëjtës moshë dhe me fillimin e ngjashëm të mësimin të gjuhës gjermane është e mundur, por jo e detyrueshme. Nëse përfundon mbikëqyrja e fëmijës në kopsht apo çerdhe, ju do të merrni dokumentacionin edukativ të fëmijës tuaj (sipas § 13B paragrafi 2 Ligjet për Kopshtet). Këto gjithashtu përfshijnë edhe formularët e vëzhgimit të të folurit.